



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Qeveria - Vlada - Government
Komuna/ Opstina/ Municipality Drenas (Glllogoc)
Zyra e Kryetarit
Nr. 01-030/01-15179 Dt. 07.05.2020

KOMUNA E DRENASIT

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika b) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040, nenit 17 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë nr. 03/L-048, nenit 7 dhe 12 të Rregullores MF - nr. – 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat financimit publik të OJQ-ve dhe Rregullores 12 nr.320-19332 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve kryetari i Komunës së Drenasit, merr këtë:

V E N D I M

Për shpalljen e Thirrjes publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve dhe personave fizik për fushën e kulturës, rinisë dhe sportit

I

1. Për implementimin e Thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores MF - nr. – 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat financimit publik të OJQ-ve dhe Rregulloren 12 nr.320-19332 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.

2. Mbështetja publike për projektet/ programet e organizatave joqeveritare dhe personave fizik do të sigurohet nga buxheti i Komunës së Drenasit - kodi 618, Kodi ekonomik Subvencionet 21120, në kuadër të programit/ nënprogramit 85001 dhe kodit funksional-0820.

II

Mjetet e përmendura në nenin 1 të Vendimit do të shpërndahen në bazë të Thirrjes publike për financimin e projektit, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

III

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes, sipas nenit II të këtij vendimi, përfshinë:

1. Teksti i thirrjes publike
2. Udhëzimet për aplikantët
3. Formularët e aplikimit

2. Formularët e aplikimit të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:

1. Formularin e përshkrimit të programit ose projektit (F1)
2. Formularin e buxhetit të programit ose projektit (F2)
3. Formularin e deklaramit të mungesës së financimit të dyfishtë të aktiviteteve nga një burim tjetër(F3)
4. Deklaratën e partneritetit (nëse zbatohet-F4)
5. Formularin e deklaramit të programeve dhe projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike (F5)
6. Deklaratën për aktivitetet e kontraktorit e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur me programin ose projektin (F6).
7. Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin(F7)
8. Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit (F8)

IV

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të Komunës së Drenasit komuna.drenas@rks-gov.net

V

Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të, Komuna e Drenasit do ta themelojë Komisionin vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.

Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit.

Anëtarët e Komisionit vlerësues do të punojë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me Rregulloren MF-nr.04/2017 për financimin publik të OJQ-ve dhe Rregullores 12 nr.320-19332 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.

VI

Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve ose të personave fizik.

Komuna e Drenasit do të njoftojë përfituesin për kohën e nënshkrimit të kontratës.

Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

VII

Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes së tij nga kryetari i komunës.

